



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr. 2007 Prot

Vlorë, më 29.10 /2025

VENDIM

Nr 13 datë 25.09 . 2025

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
PËRFUNDIMTAR 2026-2028 PËR KËSHILLIN E QARKUT VLORE**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; Ligjit nr. 84/2023, "Për buxhetin e vitit 2025"; Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar me Udhëzimin nr. 7, datë 25.02.2022; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 28.02.2025, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026–2028";

VENDOSI :

1. Të miratojë dokumentin paraprak të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, për Këshillin e Qarkut Vlorë, të përgatitur sipas Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV).
2. Të miratojë relacionin shpjegues për procesin e përgatitjes së dokumentit paraprak të PBA 2026-2028.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Sektori Financë Buxhet dhe Sherbimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimit të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore, i ndryshuar, neni 78 pika 3.

Drejtör i financës: Anisa Hyseni

Specialist i finances: Mauricio Pashaj



Ervys Mocka

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600